



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 164 dt.22.11.1995

MBI
DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE DHE PERFITIMIN E
PAAFTESISE PER MUAJIN SHTATOR 1995

Në zbatim të ligjit Nr.7710, dt.18.05.1993 “Për ndihmën ekonomike dhe përkujdesjen shoqërore”, ligjit Nr.7886, dt.08.12.1994 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.7710, dt.18.05.1993”, VKM Nr.453, 26.09.1994 “Për dhënie e ndihmës ekonomike”, VKM Nr.311, dt.11.07.1994, “Për përfitimin e paaftesisë”, Këshilli Bashkiak , i mbledhur sot me dt.22.11.1995, pasi shqyrtoi dhe relacionin e Seksionit të Ndihmës Ekonomike dhe të Mbrojtjes Shoqërore,

VENDOSI

1. Miratohet masa e ndihmës ekonomike të plotë për çdo familje sipas relacionit.
2. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **12.770 familje** gjithsej me një fond prej **31.985 milion lekë**, sipas dokumentacionit të paraqitur nga njësitë administrative.
3. Të rifuten në skemën e ndihmës ekonomike :
 - Jashar Ramollari, familje me 5 antarë, Nj.A.10
 - Nazmi Lika, familje me 4 antarë, Nj.A.11

- Idriz Idrizi, familje me 7 antarë, Nj.A.11
- 4. Agim Spahiu, familje me 5 anatarë, Nj.A.9, të trajtohet për 2 muaj, Tetor dhe Nëntor, me nivelin maksimal, të ndihmës ekonomike.
- 5. Tu ndërpritet ndihma ekonomike **123 familjeve** sipas pasqyrave të bashkangjitura.
- 6. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **1053 persona** të paaftë me një fond prej **1.438 milion lekë**.
- 7. Nuk miratohet kërkesa për trajtim me ndihmë të menjëhershme të Z.Baftjar Çaçani, Nj.A.11.
- 8. Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.170, dt.30.01.1995, nga muaji Tetor e në vazhdim të trajtohen me ndihmë ekonomike sipas legjislacionit të ndihmës ekonomike në fuqi familjet e lagjeve Selitë e Vogël dhe skema përkatësisht nga njësitë administrative Nr.5 dhe 6.

KRYETARI

BESNIK PETRELA